

SYLLABUS i Lëndës Shkrim akademik

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane
Titulli i lëndës:	Shkrim akademik
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	viti i II-të, semestri i IV
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	L + U: e enjte, ora 08:15-10:30, Salla 32
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr. Sadije Rexhepi
Detajet kontaktuese:	sadije.rexhepi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Në këtë lëndë studentët do të mësojnë dhe do të ushtrojnë procesin dhe mënyrat e realizimit të shkrimit akademik, do të mësojnë të shkruajnë lloje të ndryshme të teksteve që iu nevojiten gjatë studimeve, si detyrat e shtëpisë, punimi për një provim, protokoli, eseu, seminari.</p> <p>Mënyra për të shkruar qartë dhe saktë është njëra ndër kushtet e domosdoshme që duhet mësuar. Secili student ka mundësi që përmes ligjëratave dhe ushtrimeve të mësojë të shkruajë drejt, t'i mësojë hapat e organizimit të një punimi, të mësojë për proceset e të shkruarit të një punimi, llojet e shkrimeve gjatë studimeve, në përgjithësi të krijojë një përvojë në të shkruar.</p> <p>Të shkruarit e çfarëdo lloj shkrimi nënkupton aftësi themelore të të shkruarit, njohuri të zbatimit të gramatikës si dhe një fjalor të pasur individual në mënyrë që të realizojmë fjali dhe njësi të tjera themelore të një shkrimi të tillë. Pra, studentit gjatë ushtrimeve do të ushtrojë të shkruarit e një teksti, ai duhet të pasurohet me fjalë të duhura të nivelit akademik, të zgjedhë fjalitë e duhura, t'i radhisë ato në mënyrë të drejtë, të bëjë ndarjen e paragrafeve, të argumentojë një tekst, të përdoren në mënyrë të rregullt fusnotat dhe citatat.</p>
Qëllimet e lëndës:	Gjatë orëve që do të mbahen në kuadër të kësaj lënde mësimore studentët do të kenë mundësi të shkruajnë punime të ndryshme individuale dhe në grupe. Këtu duhet cekur se eseu apo një punim i çfarëdoshëm akademik, që konsiderohet të jetë prodhim final i një veprimtarie me rregulla teorike dhe ushtrime praktike të po atyre rregullave, është rezultat i përpjekjeve të shumta të mësuar mirë gjatë nxënies së procesit të të shkruarit akademik dhe njëherit është edhe qëllimi i këtij kursi.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Rezultatet e pritura:

	<p>Në fund të këtij kursi, pritet që studenti të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përvetësojë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të shkruar në mënyrë akademike, • të kuptojë konceptet themelore të hulumtimit • t'i mësojë fazat e rëndësishme të një hulumtimi • të mund ta organizojë hulumtimin, • të mësojë llojet e ndryshme të teksteve, • të ushtrijë aftësinë e të menduarit të arsyeshëm, • të dijë ta vendosë tezën brenda një teksti (eseu), • të dijë të argumentojë, • të mbështesë një qëndrim në mënyrë logjike, të rregullt dhe koherente • të dijë ta ndajë tekstin në pjesët përbërëse, • të mbështesë një qëndrim në mënyrë logjike, të rregullt dhe koherente, • të realizojë një diskutim retorik gjatë procesit të shkruarit, • të dijë si t'i sistemojë idetë dhe fragmentet e huazuara të tekstit sipas sistemeve ndërkombëtare të cituarit, • të përdorë me sukses gjuhën e shkruar letrare, • të njihet për së afërmi me realizimin e një prezentimi, goftë ai prezantim me shkrim apo me gojë.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	15 min.	15	4
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	2	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Totali			121 orë: 25 = 4.84

Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimi do të mbahet në formë të kombinuar nëpërmjet ligjëratave dhe ushtrimeve, do të punohet në mënyrë individuale, në çifte, dhe në grupe, ndërsa gjatë tërë semestrit studentët do të vlerësohen për rezultatet e punës së tyre. Prezantimet dhe diskutimet e studentëve rreth temave të ndryshme që do t'i zgjedhim, do të përbëjnë thelbin e punës së
-------------------------------------	--

	tyre. Këto prezantime së bashku me punimin me shkrim që do të realizohet gjatë provimit me shkrim në fund të kursit, do të jenë dëshmia më e mirë e përvetësimit të suksesshëm të lëndës së shkrimit akademik.
Metodat e vlerësimit:	<p>Pasi që kjo lëndë mësimore ngërthen në vete një kombinim të ndërsjellë të teorisë dhe të praktikës gjuhësore, një pjesë e madhe e nxënies së procesit të të shkruarit do të realizohet edhe nëpërmjet të projekteve individuale apo grupore, të cilat studentët i realizojnë para se t'i nënshtrohen provimit me shkrim. Gjatë tërë semestrit studentët do të vlerësohen për detyrat e shtëpisë, aktivitetin në klasë dhe në fund pason provimi me shkrim. Vlerësimi i tyre do të bëhet si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) vlerësimi i parë (shkruarja e paragrafit): 15% b) vijimi i rregullt: 5% c) seminari: 10% ç) prezantimi me gojë: 10% d) 50% provimi me shkrim mbi materialin e lëndës dhe eseu (në fund të kursit)
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Bünting, Karl-Dieter; Bitterlich, Axel; Postpiech, Ulrike: <i>Schreiben im Studium mit Erfolg, Ein Leitfadens</i>, Berlin, 2000 - Duden. <i>Wie verfasst man wissenschaftliche Arbeiten?: Ein Leitfadens für das Studium und die Promotion</i>, 2006 - Esselborn- Krumbiegel, Helga: <i>Richtig wissenschaftlich schreiben. Wissenschaftssprache in Regeln und Übungen</i>, UTB, Stuttgart, 2010 - Karmasin, Mathias, Ribing, Rainer: <i>Die Gestaltung wissenschaftlicher Arbeiten: Ein Leitfadens für Seminararbeiten</i>, Stuttgart, 2010 - Musai, Bardhyl: <i>Si të shkruajmë ese</i>, Tiranë 2004 - Musai, Bardhyl: <i>Si të shkruajmë, procesi dhe shkrimet funksionale</i>, Tiranë 2004
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Barbet, Sylvian/ Ballanca, Pat/ Stubbs, Marcia: <i>Shkrimi akademik</i>, Dita 2000, Tiranë - Lewis, Jill: <i>Studimi akademik</i>, 2005, Tiranë
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftimi me lëndën, me planin e lëndës
Java e dytë:	Procesi i të shkruarit – parashkrimi dhe planifikimi
Java e tretë:	Shtatë etapat e një punimi shkencor

Java e katërt:	Llojet e teksteve të punimeve (të shkruara) gjatë studimeve
Java e pestë:	Procesi i të shkruarit-shkrimi dhe redaktimi i projektideve
Java e gjashtë:	Citimet, dokumentimi i burimeve dhe shenjat e korigjimit
Java e shtatë:	Ç'është paragrafi? – Struktura dhe llojet e paragrafit
Java e tetë:	Tërësia e paragrafit dhe përgjithësimet
Java e nëntë:	Koherenca; Tipat e rrjedhës logjike të fjalive
Java e dhjetë:	Shkruarja e paragrafit (vlerësimi i parë)
Java e njëmbëdhjetë:	Argumentimi
Java e dymbëdhjetë:	Eseu, struktura dhe rëndësia e paragrafeve brenda eseut
Java e trembëdhjetë:	Struktura gramatikore e eseut (llojet e fjalive) dhe shenjat e pikësimit
Java e katërmbëdhjetë:	Llojet e eseut dhe mënyrat e organizimit të eseut
Java e pesëmbëdhjetë:	Rrjedha kronologjike dhe logjike, rrjedha e shkakut dhe e pasojës si dhe e krahasimit dhe kontrastimit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Për të fituar të drejtën për të hyrë në provim, studenti duhet të merr pjesë në mësim dhe t'i kryej obligimet e tij gjatë semestrit.